



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/04, qershor 2008), të nenit 3, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 67/29, mars 2010), neni 3 i Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr.14/2014 Për Përcaktimin e Kushteve dhe Kriereve për Sigurimin e Banimit Familjar për Familjet e Dëshmorëve, të Zhdukurve të UÇK-së, për Veteranët e UÇK-së, invalidët civil të luftës, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimat Civile të Luftës dhe Familjarëve të tyre, neni 4, paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr. 23/2010, Për Procedurat e Shpallje së Programeve të Veçanta të Banimit, organi kompetent komunal, në bazë të përcaktimit të kushteve dhe kriereve për sigurimin e banimit familjar bën shpalljen publike të :

KONKURSI

Komuna ka siguruar program të veçantë të banimit për **familjet e dëshmorëve, të zhdukurve të UÇK-së, veteranët e UÇK-së, invalidët civil të luftës, viktimat e dhunës seksuale të luftës, viktimat civile të luftës dhe familjarët e tyre** që nuk e kanë zgjidhur çështjen e banimit dhe që janë me gjendje të rëndë ekonomike duke u dhënë në shfrytëzim banesa për të krijuar kushte të përshtatshme për banim normal.

I. Të drejtën për të qenë përfitues të këtij Programi e kanë Familjet që:

- 1) Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
- 2) Kanë mbetur pa banesë/shtëpi, si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë;
- 3) Posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike dhe
- 4) Familjet që jetojnë në objekte të huaja, me ose pa qira.

II. Përcaktimi i Familjeve përfituese bëhet mbi bazën e kriereve të përparësisë, si vijon:

- a. Gjendja e banimit;
- b. Lartësia e të ardhurave;
- c. Gjendja shëndetësore;
- d. Invaliditeti i pjesëtarëve të familjes dhe
- e. Përbërja/struktura familjare.

▪ Kriteret shtesë janë:

- Familjet e Dëshmorëve;
- Familjet e kryesuara nga një Prind/Prindi vetushqyes dhe
- Familjet që kanë mbikëqyrje/përkujdesje fëmijët jetimë.

- Aplikuesit që bëjnë kërkesë për të përfitur nga programi i banimit, duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe banorë të përhershëm të komunës së Prishtinës së paku **5 (pesë) vite** para kohës së aplikimit.
- Për zgjedhjen e përfituesve nga programi i veçantë i banimit, përparësi kanë familjet me numër më të madh të pikëve, sipas tabelës së vlerësimit të përcaktuar në shtojcën 1 të “Udhëzimit administrativ nr. 21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit”.
- Në rast se aplikuesit pas vlerësimit arrijnë numër të njëjtë të pikëve, atëherë përparësi do të kenë familjet me më shumë anëtarë” (sipas nenit 5, paragrafi 4, të Udhëzimit administrativ nr. 21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit).
- Për realizimin e këtij Programi të Veçantë të Banimit, Komuna ka në dispozicion **pesëdhjetë (50) banesa** të cilat do ti ndajë për kategoritë e dala nga lufta.
- Organi kompetent komunal bën shpërndarjen e kërkesave në formë standarde, pa pagesë, për të gjithë kërkuarit e interesuar. Ato mund t’i marrin në zyrën /sportelin nr. 3, kati përdhës në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës, rruga UÇK, nr. 2, çdo ditë pune nga ora **08:30 – 15:00**.
- Konkursi mbetet **i hapur 30 (tridhjetë) ditë** nga dita e shpalljes publike në njërin nga gazetat e përditshme, duke filluar **më datë 02/08/2017** e deri **më datën 31/08/2017**.
- Aplikacionet e plotësuara dhe dokumentacioni i nevojshëm mund të dorëzohen në Komunë çdo ditë pune.
- Komisioni për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve, pas shqyrtimit të dokumentacionit të nevojshëm, bën verifikimin dhe vlerësimin e gjendjes së banimit të familjeve konkurrese në terren **brenda 30 (tridhjetë) ditëve**, ndërkaq **brenda 30 (tridhjetë) ditëve pasuese** do të bëjë vlerësimin dhe verifikimin në terren të gjendjes së parashtruesit të kërkesës.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit kohorë, të pakompletuara dhe të paplotësuara me të dhënat e nevojshme, nuk do të pranohen dhe do të konsiderohen si të pavlefshme.
- Kur aplikuesi me vetëdije jep deklaratë të rrejshme apo paraqet dokumentacion të falsifikuar, humb të drejtën për t’u kualifikuar si shfrytëzues i këtij programi të banimit social.
- Ndalohet bërja publike e të dhënave mbi procesin e përzgjedhjes para publikimit të listës së familjeve të përzgjedhura.
- Përjashtohen nga përfitimi nga ky program, familjet që kanë përfitur ndihmë në forma tjera të të njëjtit nivel ose më të lartë se sa mund të përfitohet nga programet e veçanta të banimit.
- Në bazë të nenit 8, të Udhëzimit Administrativ MMPH nr. 14/2014 për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për sigurimin e banimit familjar për familjet e dëshmorëve, të zhdukurve të UÇK-së, për veteranët e UÇK-së, invalidëve civil të luftës, viktimat e dhunës seksuale të luftës, viktimat civile të luftës dhe familjarëve të tyre, të datës 02.06.2014, Përfituesve iu ndahet banesa në shfrytëzim në afat të pacaktuar, **me vlerësim të gjendjes ekonomike çdo vit**, sipas dispozitave të Ligjit për Financimin e Programeve të veçanta të banimit .
- Forma e kontratës që jepet për këto raste është sipas Udhëzimit Administrativ . Nr. 18/2010 për përmbajtjen e kontratës për banesën me qira jo-profitabile.
- Subvencionimi i qirasë bëhet sipas nenit 10 të Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.
- Komuna në tabelën e shpalljeve do të publikon listën e familjeve të renditura sipas pikëve të fituara gjatë vlerësimit.
- Pas shpalljes së listës së familjeve të renditura sipas pikëve të fituara, pala e pakënaqur mund të parashtrorë ankesë me shkrim kundër Vendimit të Komisionit Vlerësues në MMPH, **brenda tridhjetë (30) ditëve** nga dita e pranimit të Vendimit.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në nr. e telefonit: 038/230-900 ose lokali:1050.

Kriteret Bazë	Nr.	FORMËS STANDARDE TË KËRKESËS TUAJ PËR TË PËRFITUAR NGA KY PROGRAM I BANIMIT DUHET T’I BASHKËNGJITEN DOKUMENTET, SI NË VIJIM:
Statusi i Banimit	1.	Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës - kopje për të gjithë anëtarët e familjes mbi moshën 16 vjeçare;
	2.	Familja që jeton në Shtëpi / banesë në kushte jo të mira, të papërshtatshme dhe që paraqet rrezik vazhdimi i banimit të mëtutjeshëm në të – Vërtetimi i vlerësuar dhe i konstatuar nga organet kompetente të fushës përkatëse nga komuna;
	3.	Familja e cila jeton në objekt nën normat minimale të banimit – Vërtetimi i vlerësuar dhe konstatuar nga organi kompetent i fushës përkatëse nga komuna;
	4.	Vërtetimi i tatimit mbi pronën se familja nuk ka pasuri të paluajtshme, banesë/shtëpi në territorin e Prishtinës dhe as në vendin/komunën e origjinës prej nga vjen aplikuesi;
	5.	Nëse aplikuesi /familja jeton me qira - Kontrata e qirasë e nënshkruar në praninë e Noterit;
Lartësia e të Ardhurave	6.	Certifikatë që posedon apo nuk posedon në Kadastrë pronë të pa luajtshme – e paraqitësit të kërkesës dhe e anëtarëve të familjes që janë 18 vjeç apo më të vjetër, këtu duhet të përfshihen gjithashtu detajet e prindërve të vdekur dhe/ose kujdestarëve;
	7.	Certifikata nga organi përkatës komunal për lartësinë e tatimit mbi pronë - e paraqitësit të kërkesës dhe e anëtarëve të familjes që janë 18 vjeç apo më të vjetër, këtu duhet të përfshihen gjithashtu detajet e prindërve të vdekur dhe/ose kujdestarëve;
	8.	Pasqyra e Llogarisë nga TRUSTI: Periudha e Raportimit për dymbëdhjetë (12) muajt e fundit;
	9.	Vërtetim nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që aplikuesi dhe ndonjë nga anëtarët e familjes së tij nuk kryejnë aktivitet tregtar;
	10.	Vërtetimi nga Qendra Rajonale për punësim/ Zyra Komunale për Punësim nga MPMS - për të gjithë anëtarët e familjes mbi moshën 18 vjeçare të cilët janë si kërkues pune, por që nuk janë të punësuar;
	11.	Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për çdo pjesëtarë të familjes i cili është i punësuar në Institucione shtetërore apo në Sektorin privat ku cilësohet pozicioni i punës dhe paga e fituar (neto);
	12.	Vërtetim nga organet kompetente i cili deklaron të ardhurat për personat të cilët janë në pension – Vendimi (origjinal);
	13.	Vendimet e pensioneve të personave me aftësi të kufizuara (PPAK) nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për anëtarët e familjes duhet të jenë me afat të vlefshëm;
	14.	Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK-ja) që verifikon gjendjen tatimore në ATK - për aplikuesin dhe anëtarët të familjes që janë 18 vjeç apo më tepër, këtu duhet të përfshihen gjithashtu edhe detajet e prindërve të vdekur / dhe ose kujdestarëve;
	15.	Dëshmia /deklaratë mbi gjendjen e llogarisë bankare për ekonomizim në Kosovë – Raportimi i qarkullimit për: 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit të paraqitësit të kërkesës dhe anëtarëve të punësuar në familje;
Gjendja Shëndetësore	16.	Familjet që kanë pjesëtarë të familjes me sëmundje të rënda kronike dhe me probleme të përhershme shëndetësore – Të dhënat mbi këtë gjendje serioze shëndetësore të aplikuesit apo të anëtarëve të tjerë duhet të dokumentohen me vërtetim nga mjeku specialist ose komisioni i mjekësisë, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi;
	17.	Certifikata e mjekut për personin me aftësi të kufizuara – të aplikuesit dhe/ose e anëtarëve të tjerë të familjes nëse parashtruesi i kërkesës apo pjesëtarë tjetër i familjes paraqesin kërkesën në baza të aftësisë së përhershme të kufizuar;
Invaliditet	18.	Dëshmi apo Vërtetim mbi përcaktimin e shkallës së Invaliditetit dhe përqindjen e përcaktuar të dëmtimit trupor – Vendim apo Vërtetim në përputhje me legjislacionin në fuqi që do të thotë i konstatuar sipas vlerësimit mjekësor për shkallën e invaliditetit të cilin e bën Komisioni mjekësor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
Struktura e Familjes	19.	Dëshmi apo dokument i lëshuar nga organi kompetent i cili e përcakton saktësisht - statusin e aplikuesit apo personit i cili i përket apo takon njëri nga kategoritë e dalura të Luftës Çlirimtare të Kosovës;
	20.	Certifikata apo deklarata e bashkësisë familjare;
	21.	Certifikatat e lindjes – për të gjithë anëtarët e familjes;
	22.	Ekstrakti i lindjes – vetëm për aplikuesin;
	23.	Vërtetimin mbi vendbanimin e përhershëm;
	24.	Çdo aplikues duhet të jetë banorë i komunës së Prishtinës së paku 5 (pesë) vite para kohës së aplikimit – kjo vlen për personat e ardhur nga komuna tjera, të dëshmohet me dokumente relevante për këtë qëllim, p.sh. Fletë shpërngulja nga komuna e ardhur;
	25.	Vërtetimi nga shkolla – për fëmijët nga moshë 6–18 vjeçare dhe 18–25 vjeçare të cilët janë në shkollim;
	26.	Certifikata e kurorëzimit – për personat e martuar në familje, posaçërisht për bashkëshortin/bashkëshorten e paraqitësit të kërkesës, nëse ai person është i përfshirë në kërkesën e paraqitur;
	27.	Certifikata e shkurorëzimit në rastin e çifteve të divorcuara, që kanë një apo më tepër fëmijë në mbikëqyrje/përkujdesje prindërore – të dëshmohet me Vendim gjyqësor për mbikëqyrjen/përkujdesjen prindërore të fëmijës apo fëmijëve (origjinali ose i noterizuar);
	28.	Familja e cila ka në mbikëqyrje dhe përkujdesje fëmijë/fëmijët jetimë – të dëshmohet kujdestaria me vendim nga autoritetet kompetente;
	29.	Të gjitha dokumentet e kërkuara nuk mund të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj nga dita e lëshimit të tyre;
	30.	Dokumentet shtesë të nevojshme sipas rasteve.

¹Udhëzimi Administrativ nr. 23/2010 Për Procedurat e Shpalljes së Programeve të Veçanta të Banimit.